



Në bazë të Programit për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësim të kushteve për qëndrimin e turistëve në qytetin e Shkupit për vitin 2020 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 1/20 dhe 11/20), Qyteti i Shkupit shpall:

**Thirrje publike
për tubimin e fletëparaqitjeve për përkrahje financiare për realizimin e
projektit – shtimi i peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup**

I. Pjesëmarrja në thirrjen publike

Të drejtën e pjesëmarrjes në këtë thirrje publike e kanë të gjitha shoqatat civile, fondacionet, federatat, institucionet dhe shoqëritë tregtare të cilët do të parashtrorjnë projektet dhe dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në pajtim me thirrjen publike.

II. Mjetet e parapara

Mjetet ndahen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2020 dhe janë të parapara në Programin për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësimin e kushteve për qëndrimin e turistëve në qytetin e Shkupit për vitin 2020, në shumën e përgjithshme prej 600.000 denarë.

III. Parashtruesi duhet t'i përmbush këto kritere vijuese për përzgjedhjen e subjektit i cili do ta realizojë projektin - shtimi i peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup

KRITERET	Numri maksimal i pikëve vlerësuese
1. Përvoja e parashtruesit për nga aspekti i realizimit të projekteve të njëjta dhe të ngjashme.	20
2. Plani i detajuar financiarë për mjetet e nevojshme për realizimin e projektit dhe qëndrueshmëria e shpenzimeve të parapara në planin e propozuar financiarë.	20
3. Plani i detajuar për realizimin e aktiviteteve të parapara* për shtimin e peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup.	15

4. Kapaciteti i organizatës që të realizohen aktivitetet e parapara * (numri i të punësuarve, automjetet e specializuara për bartjen e materialit të nevojshëm për shtimin e peshqve, persona të angazhuar me honorarë, sigurimi i materialit të nevojshëm për shtimin e peshqve).	30
5. Angazhimi i personave të pavarur, anëtarëve të shoqatave ekologjike të cilët do të angazhohen për realizimin e monitorimit të procesit të përgjithshëm lidhur me shtimin e peshqve, duke ofruar përshkrimin e shpenzimeve për këta personale sipas pozitave përkatëse (transporti, mëditjet).	15
Numri maksimal i pikave vlerësuese	100

***Vërejtje:** Në lidhje me aktivitetet e parapara në pikat 3 dhe 4 të kriterëve të kësaj thirrje publike konsiderohen:

Aktivitete sipas projektit	Pesha (madhësia e peshqve për copë)	Pesha mesatare e peshqve për copë në kg	Numri i peshqve për copë	Materiali për shtimin e peshqve në kilogram
Shtimi me material të shtimit të peshqve (peshk) – trofta endemike maqedonase (<i>Salm o macedonicus</i> Karaman, 1924)	nga 20 gramë deri më 50 gramë	0,04	2800	nga 105 deri më 115
Shtimi me material të shtimit të peshqve (peshk) – trofta endemike maqedonase (<i>Salm o macedonicus</i> Karaman, 1924)	nga 50 gramë deri më 200 gramë	0,15	1200	nga 175 deri më 185
Shtimi me material të shtimit të peshqve (peshk) – krap (<i>cyprinus carpio</i>) dhe lloje të tjera autoktone të peshkut bardhë që jeton në ujëra të ëmbla	nga 500 gramë deri më 800 gramë	0,7	800	nga 555 deri më 565

Në procedurën për përcaktimin e mjeteve buxhetore nga Programi për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësimin e kushteve për qëndrimin e turistëve në qytetin e Shkupit për vitin 2020, do të shqyrtohen ato projekte të cilat në bazë të kriterëve do të sigurojnë së paku 80 pikë vlerësuese.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm, të cilin aplikuesi duhet ta dorëzojë me Fletëparaqitje për përkrahje financiare

Krahas fletëparaqitjes për përkrahje financiare e cila duhet të jetë e plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja shtypi të alfabetit cirilik, të nënshkruar nga personi kompetent dhe i vërtetuar me vulën e shoqatës, fondacionit, federatës, shoqërisë tregtare ose institucionit, aplikuesi detyrimisht duhet t'i dorëzojë edhe shtojcat e mëposhtme:

- Gjendja vijuese nga Regjistri Qendror ose Vendim për regjistrimin e shoqatës apo fondacionit;
- Vërtetim për ndalimin e pjesëmarrjes në procedurat e thirrjeve publike, ndarje të marrëveshjeve për furnizim publik dhe marrëveshjeve për partneritet publik privat (Regjistri qendror);
- Propozim – projekt digjital i plotësuar me shkronja të shtypura të alfabetit cirilik;
- Plan financiar digjital i plotësuar me shkronja të shtypura të alfabetit cirilik;

V. Dokumentacioni i nevojshëm, të cilin aplikuesi duhet ta dorëzojë te projekti i propozuar

Aplikuesit si shtojcë të propozim – projektit duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente shoqëruese:

- biografi profesionale të ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit;
- biografinë e personave të jashtëm (të pavarur) të cilët do të mbikëqyrin plotësisht procesin e shtimit të peshqve;
- buxheti vjetor i aplikuesit për vitin aktual;
- listë referimi;
- më së paku dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme; dhe
- përkrahje me shkrim nga organizata tjera ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit (instituti i blegtorisë – enti për peshkim, instituti Hidrobiologjik ose miratimi i Inspektoratit shtetëror për bujqësi – Seksioni peshkim)
- dëshmi që aplikuesi ka siguruar ose do ta sigurojë materialin për peshkim;

Vërejte: Fletëparaqitjet me dokumentacion të paplotë ose të cilat do të dorëzohen pas përfundimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.

VI. Fusha me përparësi të projektit – Shtimi i peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup

Fusha me përparësi të projektit janë:

- Zhvillimi i turizmit të peshkimit sportiv në qytetin e Shkupit;
- Promovimi i turizmit të peshkimit sportiv;
- Pasurimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet e Shkupit;
- Rikthimi i troftës maqedonase (*Salmo macedonicus* Karaman, 1924) dhe rikthimi i krapit (*Cyprinus carpio*);
- Pasurimi i ofertës turistike të qytetit të Shkupit nëpërmjet zhvillimit të këtij lloji të turizmit sportiv si pjesë e turizmit ekologjik;

VII. Periudha dhe vendi i realizimit të projektit

Projekti do të realizohet deri në muajin dhjetor në vitin 2020.

Vende të parashikuara për pasurimin me peshq:

- Lumi Vardar - Troftë endemike (*Salmo macedonicus* Karaman, 1924)
- Liqeni i Treskës - Troftë endemike (*Salmo macedonicus* Karaman, 1924)
- Liqenet në Parkun e qytetit - Krap (*cyprinus carpio*)

VIII. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

Kryetari i Qytetit me aktvendim formon Komisionin për realizimin e Thirrjes publike.

Komisioni shqyrton fletëparaqitjen për përkrahje financiare dhe dokumentacionin e depozituar si shtojcë.

Aplikuesit do të njoftohen për rezultatet në një afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të Thirrjes publike.

Aplikuesit të cilët kanë përmbushur kriteret në përputhje me Thirrjen publike do të lidhin kontratë për ndarjen e mjeteve financiare me Qytetin e Shkupit.

IX. Afati dhe mënyra e depozitimit të fletëparaqitjeve

Afati për depozitimin e fletëparaqitjeve është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së Thirrjes publike. Thirrja publike shpallet më 02.12.2020 dhe zgjat deri më 23.12.2020.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin duhet të depozitohet në zarf të mbyllur dhe të vulosur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim lokal ekonomik, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënimin – Fletëparaqitje për Thirrje publike për përkrahje financiare për realizimin e projektit – Shtimi i peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup, Sektori për zhvillim lokal ekonomik)

Fletëparaqitja për përkrahje financiare dhe konstruksioni financiar janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, Seksioni për turizëm.

Pyetje sqaruese mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Sektorit për zhvillim lokal ekonomik.

Telefoni për kontakt: (02) 3297-272 dhe (02) 3297-218 – Sektori për zhvillim lokal ekonomik

Qyteti i Shkupit